

KONTRATE SHITJE KUOTASH
(Bazuar ne nenet 750 e vijues KC dhe
nenit N.73 i ligjit 9901 date 14.04.2008 Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare)

Sot me 01.09.2022,

Mes

Nga njera ane:

- **Znj. Veronica Bernardini**, qytetare italiane lindur ne Siena, me 24.05.1993, rezidente ne Via della Repubblica, 162 Poggibonsi (Itali), me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e kartes se identitetit nr. CA36510AH, zoteruese e 60% te kapitalit te Shoqerise;
- **Z. Danilo Salvatore Simone Adamantino**, qytetar italian lindur ne Catania, me 06.07.1991, rezident ne Via dell'Ionio, 1 ACI Catena CT (Itali), me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit nr. CA41624FX, zoterues i 20% te kapitalit te Shoqerise;
- **Z. Andrea Giuseppe Ardita**, qytetar italian lindur ne Catania, me 22.04.1990, rezident ne Via Chiusa della Corte, 1 ACI Catena CT (Itali), me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i pashaportes nr. YA4632593, zoterues i 20% te kapitalit te Shoqerise
(palet shitese)
- **Znj. Anna Maria Incarbone**, qytetare italiane, lindur ne Niscemi – Caltanissetta(Itali) me 15.12.1956, dhe rezidente ne Via S.Benedetto da Norcia, 10 – Modica(Itali), madhore me zotesi te plote per te vepruar, karte identiteti nr. AT 3364459,
(pala blerese)

KUSHTE PARAKONTRAKTORE

- 1- Znj. Anna Maria Incarbone, (pala blerese) ka vullnet te bleje 100% te kuotave te shoqerise BENNET HOLDING shpk.
- 2- Znj. Veronica Bernardini, Z. Danilo Salvatore Simone Adamantino, Z. Andrea Giuseppe Ardita (palet shitese) jane pronare te 100% te kuotave te kapitalit te shoqerise BENNET HOLDING shpk dhe kane vullnet te shesin 100% te ketyre kuotave.sic eshte vendosur me Vendim te Asamblese se Ortakeve.

OBJEKTI I KONTRATES:

Me ane te kesaj kontrate SHITESIT transferojne ne menyre te parevokueshme tre kuota, baraz me 100% te kapitalit ne favor te BLERESIT, i cili pranon titullin e tij te pronesise mbi kuotat objekt – kontrate, me kushtet ne vijim :

CMIMI KONTRAKTOR:

Kuotat objekt - kontrate shiten me nje cmim te barabarte me vleren nominale.Cmimi kontraktor pranuar prej paleve eshte 100.000 leke (njqind mije) leke.

GARANCITE:

SHITESIT garantojne BLERESIN se kuotat – objekt kontrate jane te lira nga te gjitha debitet, pretendimet e te treteve mbi to, si dhe nga cdo barre pengu apo hipoteke.

BLERESI deklaron se pranon te bleje kuotat me te gjitha te drejtat dhe detyrimet e lidhura me te, ne daten e nenshkrimit te kesaj kontrate.

EFEKTET JURIDIKE:

Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe regjistrimin e kalimit te kuotes, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 « Per Qendren Kombetare te Biznesit », pjesemarrja ne kapitalin e shoqerise BENNET HOLDING shpk paraqitet si vijon :

1. Znj. ,Anna Maria Incarbone - posedon nje kuote, baraz me 100% te kapitalit, me nje kontribut prej 100.000 (njqind mije) leke.

DITA EFEKTIVE E KONTRATES:

Kjo kontrate hyn ne fuqi ne daten e nenshkrimt te saj.

Sa me lart, lexohet nga palet dhe nenshkruhet lirisht prej tyre:


PALET KONTRAKTORE


PALET SHITESE


Znj. Veronica Bernardini

Z. Danilo Salvatore Simone Adamantino


Z. Andrea Giuseppe Ardita







PALA BLERESE



Znj. Anna Maria Incarbone

